



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 80/17
Prishtinë, më 28.02.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Sali Morina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontić.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti - Ministër i Financave dhe Agim Kransiqi – zv. Ministër i Financave.

Pjesëmarrës tjerë të pranishëm: Etleva Malushaj nga LVV, Eugen Cakolli nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, Arbnore Zogjani (praktikante) dhe Kujtesa Shala (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të Komisionit, dt. 14.02.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Projekligjit nr.05/L-152 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave;**
- 4. Shqyrtimi i Projekligjit nr.05/L-153 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar;**
- 5. Shqyrtimi i Projekligjit nr.05/L-154 për Ratifikimin e Protokollit Financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS;**

6. **Shqyrtimi i Projekligjit nr.05/L-155 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;**
7. **Shqyrtimi i Projekligjit Nr.05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;**
8. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari - konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura të Komisionit, dt. 14.02.2017**

Safete Hadërgjonaj – theksoi se proceverbali është mirë

Kryetari – konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.02.2017, miratohet pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Projekligjit nr.05/L-152 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave**

Kryetari – Qeveria e Kosovës, në bazë të nenit 18 dhe 93.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të nenit 10, paragrafit 1, 4 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-052 për marrëveshjet Ndërkombëtare, i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projekligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Agim Kransiqi – theksoi se kjo marrëveshje i mundëson Qeverisë së Kosovës marrjen e huasë nga Qeveria e Austrisë me vlerë prej 30 milion eurove për investime kapitale ku bën të ditur edhe periudhën e kthimit të huasë që është 15.5 vite me grejs periudhë 4 vjeçare, normë interesi 0% e cila është e ndryshueshme varesisht nga rivendosja vjetore e normës së skadimit nën kujdesin e OECD-së. Sektorët të cilët pritet të investohen mjetet janë trajtimi i ujrave të zeza, furnizimi me ujë të pijes, në shëndetsi, arsim, bujqësi etj. që janë në përputhje me prioritetet e Qeverisë dhe të parapara në programin e kombëtar për zhvillim. Projektet të cilat kanë filluar të financohen në kuadër të kësaj marrëveshjeje, në sektorin e arsimit deri më tani janë shpenzuar 5 milion euro dhe sektorin e shëndetsisë, përkatësisht në fushën e kardiologjisë e që janë shpenzuar shuma prej 2.6 milion eurove. Z. Krasniqi deklaroi se shuma e mbetur, pritet të negociohet për investimin e projekteve në sektorët e lartpërmendur, investime të cilat do të zhvillohen në nivel komunal. Ai po ashtu tha se secili projekt që dakordohet në mes të palëve, do të kalojë në procedura të ratifikimit në Kuvendin e Kosovës.

Safete Hadërgjonaj – kërkoi të dijë nëse shumat të cilat u përmendën janë në kuadër të marrëveshjes në fjalë dhe sa është shuma që është investuar deri më tani në sektorin e edukimit dhe shëndetsisë? Po ashtu znj. Hadërgjonaj kërkoi të dijë më detajisht edhe për investimet e sektorëve të cilat janë në pritje.

Avdullah Hoti – theksoi se marrëveshja fillestare me Qeverinë e Austrisë është e vitit 2012 e cila ka pasur afat deri në vitin 2014. Gjatë asaj periudhe, është miratuar vetëm projekti i fushës së arsimit ku përfshihen 4.5 milion euro. Ndërkaq është shtyer afati i shfrytëzimit të 20 milion eurove nga viti 2012 deri në fund të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe kohore, është aprovuar vetëm projekti për shëndetsi që

janë përfshirë 2.7 milion euro. Mirëpo, ministri përmendi shumë ende të pashfrytëzuar nga marrëveshja që ka skaduar në dhjetorin e vitit 2016 e që mban vlerën prej 15 milion eurove. Si rrjedhojë e kësaj, ministri tha se kemi rinegociuar marrëveshjen me disa kushte të përmirësuara dhe kemi rritur shumë edhe për 15 milion euro të tjera shtesë ku gjithsej, shuma e kredisë rritet në 30 milion euro. Sapo të ratifikohet kjo marrëveshje në seancën e Kuvendit të Kosovës, do t'i sjellim projektet veç e veç në Komision dhe në Kuvend.

Shqipe Pantina – në bazë të marrëveshjes kuptohet se kemi të bëjmë më shumë me fusha se sa projekte të caktuara, për të cilat mirret huaja 30 milion euro. Pra nuk ka projekte të veçanta për këto fusha siç është rasti në fushën e bujqësisë për të cilën nuk ka projekt të caktuar por përmendet vetëm “sistemi i ujitjes”. Në bazë të informacionit të mangët, pse nuk përmendet së paku se në cilën komunë apo nga cila kompani do të bëhet sistemi i ujitjes pasi që kemi shumë kompani publike apo private të cilat mund të përfitojnë nga kjo fushë. Prandaj është e nevojshme të bëhet detajizimi të projektit dhe pyeti se në sektorin e ujrave të zeza dhe ujit të pijshëm, se në çfarë komuna do të bëhet realizimi i projektit. Nërkaq, për e-qeverisjenu interesuar të dinte se në çfarë niveli është? Pyetjen tjetër ajo e bëri në lidhje me nenin 3 të marrëveshjes që bëhet fjalë për Kushtet për Kreditë Koncesionale se çfarë nënkupton “35%”? Pantina pyetjen e fundit e drejtoi në lidhje me normën e interesit dhe thotë, dhe theksoi në qoftë se shteti i Kosovës nuk mund të paguajë në të ardhmen kredinë me normën e interesit 0%, deri sa mund të rritet norma e interesit.

Avdullah Hoti – kjo është marrëveshje kornizë brenda të cilave kemi të drejtë të negociojmë projekte veç e veç. Ai mori shembull një komunë ku do duhej të realizonin projektin për ujërat e zeza dhe tha se në atë komunë, paraprakisht do duhej të vinte pala Austriake për t'i kryer studimet e vizibilitetit ku vlerëson koston e projektit, përfitimet e komunitetit etj. dhe nëse ky studim do rezultonte pozitivisht, do bëhet negociimi negociim me palën Austriake për të realizuar atë projekt. Sa i përket pyetjes se Deputetes Pantina për paqartësinë e “35%” në Nenin 3 të Marrëveshjes, këto janë marrëveshje koncesionale pra që nuk shkojnë me kushte të tregut por në bazë të rregullave të OECD-së.

Enver Hoti – pyeti se a janë të informuara të gjitha komunat për projektin dhe çfarë përfitimi do të kishin në kuadër të këtij projekti. Ai po ashtu bëri pyetjen se sa mjete afërsisht janë të planifikuara nga kredisë për secilën komunë? Z. Hoti theksoi se është e domosdoshme që të mos përsëriten ndarjet buxhetore ashtu siç ka ndodhur me Buxhetin e Republikës së Kosovës për komunat të cilat për një kohë të gjatë (7-8 vite) sanksionohen. Nëse disa komuna prjashtohen nga lista për realizimin e projekteve për të cilat diskutohet, atëherë nuk e di pse duhet të votohen këto marrëveshje?!

Shukri Buja – përveç përqindjes së lartëpërmendur në nenin 3 të marrëveshjes, cilat janë kushtet tjera që i kërkojnë austriakët për të realizuar dhënien e kredisë?

Avdullah Hoti – shpjegoi se këto kredi për të cilat po diskutohet, janë kredi me kushte të buta ku normat e interesit janë koncesionale. Këto kushte njëkohësisht na kushtëzojnë neve që të përdorin teknologjinë e Austrisë që normalisht njihet si shumë teknologji e avancuar. Hoti tha se do të ndihej mirë nëse Kuvendi i Kosovës ratifikon marrëveshjen ku për 20 apo 30 vitet e fundit, do të mundësohej lidhja në mes Kosovës dhe shtetet ndërkombëtare të përmendura që do të tregonte një stabilitet afatgjatë ekonomik për vendin.

Bali Muharremaj – tha se do të ishte mirë që këto projekte të ndahen në mënyrë proporcionale. Ka disa komuna që kanë nevojë urgjente që të intervenohet në realizimin e këtyre projekteve siç janë ujrat e zeza.

Besa Gaxherri – theksoi se një marrëveshje me një shtet siç është Austria duhet të votohet.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.05/L-152 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-153 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar

Kryetari – Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 18 dhe 93.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të nenit 10, paragrafit 1.4 dhe 2 të Ligjit 04/L- 052 për marrëveshjet Ndërkombëtare, i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë.

Agim Krasniqi – theksoi se marrëveshja në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për bashkëpunim financiar është projekt kornizë. Marrëveshja në fjalë është nënshkruar pasi që kanë përfunduar procedurat ligjore dhe janë marrur aprovimet e nevojshme ashtu siç është paraparë me Ligj. Kjo marrëveshje përmban kushtet bazë financiare për realizimin e projekteve për trajtimin e ujërave të zeza, furnizim me ujë dhe infrastrukturë. Shuma e kësaj kredie është në vlerë prej 62 milion eurove me normë vjetore të interesit 0%, grejs periudhë 1.5 dhe periudha e kthimit 17 vite. Po ashtu ai tha se gjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, kanë qenë të përfshira të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij projektligji. Kjo kredi do të përfshihet në projekte regjionale të caktuara.

Besa Gaxherri – pyeti se çka parashikohet në trajnimin e ujërave të zeza dhe infrastrukturë?

Avdullah Hoti – sqaroi se marrëveshja për kredinë 62 milion euro, është marrëveshje kornizë. Ai theksoi se projekti i parë që do të financohet brenda kësaj kornize është projekti për mbrojtjen e Liqenit të Batllavës nga ujrat e zeza për të gjitha fshatrat përreth. Sa i përket fushave të tjera të përcaktuara, është edhe fusha e infrastrukturës ku dha detaje se ministri i infrastrukturës është duke zhvilluar ide rreth kësaj çështjeje duke thënë kështu se ka të bëjë me sinjalizimin e rrugëve, pajisje të reja që mundësojnë vlerësimin e frekuencës së automjeteve etj.

Shqipe Pantina – bëri pyetjen e parë ku tha se sa i përket mallrave dhe shërbimeve, a ka hapsirë të zgjedhen këto shërbime me çmim më të ulët apo këto zgjedhje i bën shteti i Hungarisë? Pyetjen e dytë e bëri në lidhje me marrëveshjet në përgjithësi, ku tha se a ka qenë e mundur që marrëveshje të tilla të bëhen me secilin shtet dhe cila është strategjia që këto marrëveshje bëhen pikërisht me këto shtete?

Avdullah Hoti – sa i përket marrëveshjeve me shtetet e cekura tha se Kosova është e orientuar në Bashkimin Evropian. Ne kemi lidhur marrëveshje edhe me shtetet tjera evropiane siç është rasti edhe Gjermanisë në vlerë prej 400 milion eurove deri më tani. Kjo marrëveshje për kredi, bazohet në shprehjen e vullentit të shtetit të Hungarisë për të ndihmuar shtetin e Kosovës me 0% normë të interesit.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni me nëntë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projekligjin nr.05/L-153 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar.

5. Shqyrtimi i Projekligjit nr.05/L-154 për Ratifikimin e Protokollit Financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS

Kryetari – Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të nenit 18 dhe 93.3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 10, paragrafi 1,4 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-154 i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin për Marrëveshjen për hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS.

Agim Krasniqi – Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së Qeverisë së Kosovës dhe Francës e nënshkruar me 5 korrik 2016 në Paris, në takimin e kryeministrit të Ballkanit Perëndimor. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin Financiar mes Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Francës që përfaqësohet nga NATIXIS. Marrëveshja ka për qëllim trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Prishtinës, Obliliqit dhe Fushë Kosovës. Ajo që vlenë dhe është me rëndësi është se kjo marrëveshje është në harmoni të plotë me programin e qeverisë dhe i ka përfshirë të gjithë akterët kryesisht në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë që merret me këtë projekt. Marrëveshje është në vlerë 66 milion euro me kushte të volitshme, norma efektive e interesit është 0.036% , grejs periudha është 5 vite dhe është 25 vite. Të gjitha këto kredi janë pjesë e planit të Ministrisë që e përgaditë Njësia për borxhe dhe janë brenda kërkesave ligjore dhe mbi bazën e strategjisë për borxhe publike.

Avdullah Hoti – theskojs se marrëveshja parasheh financimin e projektit konkret për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në tri komuna. Shuma totale e projektit është më e madhe, por jemi duke negociuar me KfW për mundësinë e financimit të plotë të projektit.

Shukri Buja – theksoi se në projektin ideor, është paraparë që pjesë e projektit përveq tri komunave të përmendura të jenë edhe Komuna e Lipjanit dhe e Shtimes, si pjesë e rrjetit për trajtimin e ujërave të zeza në një impiant. Unë kërkojë që edhe këto komuna të jenë pjesë e financimit të projektit.

Avdullah Hoti – sqaroi se të gjitha ato ide për një projekt kapital që vjen prej ministrive ose prej komunave, duhet të kalojnë në Komitetin Kombëtarë për Investime ku janë 5 ministra, të gjithë donatorët, USAID, GIZI, KfW dhe ambasadorët të vendeve të ndryshme, ku duhet të arsyetohen nga ministrat përkatës ose nga kryetaret e komunave. Ky është një proces që e rrit transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë njëkohësisht.

Safete Hadërgjonaj - ngriti shqetësimin e realizimit shumë të vogël të këtyre marrëveshjeve të ratifikuara në Kuvend. Ajo gjithashtu theksoi se nëse marrëveshjet nuk kryhen në kohë atëherë shtohet një kumatë ndëshkuese, e që faktikisht akoma nuk janë të realizuara projektet, me ç'rast qytetarët ndihen inferiorë. Deri me tani janë miratuar tri marrëveshje sa i përket ujërave të zeza , ku përveç këtyre, kemi pasur edhe marrëveshje tjera që na lë për të kuptuar se ne do t'ua kalojmë edhe shteteve tjera në trajtimin e këtij problemi me ujërat e zeza, por në fakt gjendja nuk është e mirë në këtë sektor!

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në baze të propozimeve , kryetari konstatoi se komisioni me nëntë

vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Protokollit Financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS;

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-155 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryetari - Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të nenit 18 dhe 93.3 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-155 për Ratifikim e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK- Linja e Dytë kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Agim Krasniqi – sqaroi se Qeveria e Kosovës në vitin 2014 ka emetuar një garancion shtetëror për FSDK me shumën prej 10 milion eurove për sigurim të sektoreve të vegjël dhe sektorit bankar. Sipas projeksioneve financiare për arritjen e këtyre niveleve të sigurimit depozitave, shuma duhet të jetë 4 milion euro në vitin 2016 përkatësisht rumbullakson 20 milion në vitin 2018. E gjithë vlera e kredisë është 24 milion euro e ndarë në tri transhe ku 14 milion euro zotohen në rastin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes financiare, 6 milion euro bëhen efektive në vitin 2018 dhe në rastin e rritjes së nivelit të depozitave sikur sistemi bankar në Kosovë, nga 4.000 në 5.000 dhe 4 milion euro bëjnë efektive në vitin 2020. Në rast skadimi të linjes së parë kreditore kohëzgjatja e kredisë është 7 vite me mundësi shfrytëzimi. Amortizimi i kredisë së përdorur është 12-15 vite me këste gjysmëvjeqare. Norma e interesit është 1% në vit kjo normë është variabile, tarifa e zotimit është 0,5% në vit për mjetet e zotuarat për transhe, tarifa menaxhuese është 1% e vlerës e transhit të disponueshme për zotim

Pas perfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.05/L-155 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari – siq jeni të njoftuar ndryshimet dhe plotësimet me këtë ligj janë të ndërlidhura me zbatimin e marrëveshjes së Kosovës me FMN-në.

Shqipe Pantina - theksoi se është kundër nenit 3 siç është propozuar. Unë e kam potencuar edhe më herë që janë kundër heqjes së drejtës së Komisionit për Mbikqyrjen e Financave Publike për dhënien e pëlqimit për auditorët e jashtëm të përzgjedhur nga Banka Qendrore.

Kryetari – me ndryshimet në nenin 3 ka për qëllim që të ruhet autonomia e BQK-së si institucion i pavarur në përzgjedhjen e auditorëve të jashtëm.

Shukri Buja - e ngriti qështjen se në nein tre po flitet për auditorët e jashtëm dhe firmat e auditimit dhe se terminologjia duhet të jetë e unifikuar. Po ashtu duhet të analizohet shprehja “emëron”. Në qoftë se në këtë nen flitet për diçka në pjesën e parë, flitet për të njëjtin subjekt kush e emëron dhe në fund duhet të jetë kush e shkarkon. Me percaktimin “emeroj” po ngarkohet Bordi për të emëruar auditorët e jashtëm jo firmën. Une mendoj që duhet të jetë përzgjedh pasiqë procedurat e emerimit dhe përzgjedhjes dallojnë.

Shqipe Pantina – theksoi se periudha pesë vjeqare e auditimit nga të njëjtit auditor është shumë dhe se kjo mundet me korrespondu me mandatin e guvernatorit. Prandaj propozojë që të zbritet në tri vite. Edhe nëse ia heq Kuvendit mbikqyrjen, 3 vite do të ishte më standard.

Kryetari – meqë kemi të bëjmë me zhvillimin e konkursit për zgjedhjen e auditoreve të jashtëm, atëherë fjala adekuate është “përzgjedhë”. Më pasi kryetari propozoi qe te miratohen amandametet si ne vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, në rreshtin e katërt dhe pestë, teskti “pesëmbëdhjetë (15) ditëve”, zëvendësohet me tekstin “tridhjetë (30) ditëve”. Po ashtu në rreshtin e pestë, pas fjalës “marrjes”, shtohet lidhëza “së”

Amendamenti 2

Neni 3, në rreshtin e parë, fjalët “do të emëroj” zëvendësohet me fjalët “përzgjedhë”. Në rreshtin e tretë, fjalët “do të emërohet”, zëvendësohen me fjalët “ nuk përzgjedhet”. Si dhe në rreshtin e pestë, fjalët “firma e auditimit”, zëvendësohet me fjalët “auditorët e jashtëm”

Shqipe Pantina – theksoi se unë abstenoj në këto propozime.

Kryetari - propozoj se si Komision të rekomandojmë që këto qështje që shqyrtuam të radhiten për shqyrtim ne seancën plenare të radhës me datë 2 Mars 2017 përmes plotësimit të rendit të ditës dhe votimit të shmangies së Rregullores së Kuvendit.

Pas perfundimit te diskutimeve dhe ne baze te propozimev , kryetari konstatoi se komisioni me nëntë vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenim, nxori këtë

Raport me rekomandime

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin Nr.05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës përmes plotësimit të rendit të ditës Rendit të ditës të seancës plenare më 2 mars 2017 dhe shmangien nga Rregullorja e Kuvendit, me amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, në rreshtin e katërt dhe pestë, teskti “pesëmbëdhjetë (15) ditëve”, zëvendësohet me tekstin “tridhjetë (30) ditëve”. Po ashtu në rreshtin e pestë, pas fjalës “marrjes”, shtohet lidhëza “së”

Amendamenti 2

Neni 3, në rreshtin e parë, fjalët “do të emëroj” zëvendësohet me fjalët “përzgjedhë”. Në rreshtin e tretë, fjalët “do të emërohet”, zëvendësohen me fjalët “ nuk përzgjedhet”. Si dhe në rreshtin e pestë, fjalët “firma e auditimit”, zëvendësohet me fjalët “auditorët e jashtëm”

2. Komisionet e përhershme: Komisioni për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të shqyrtojnë Projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa dhe të paraqesin Raportin me rekomandime.
3. Komisioni propozon që të bëhet plotësimi i rendit të ditës të seancës plenare më 2 mars 2017, dhe shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 56, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, dhe atë si në vijon:
 - 3.1. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-152 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave;
 - 3.2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-153 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar;
 - 3.3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-154 për Ratifikimin e Protokollit Financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit Financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS; dhe
 - 3.4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-155 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

8. Të ndryshme

Bali Muharremaj - pyeti se a është i autorizur nga Komisioni siç kemi biseduar në Punëtorinë në Durrës, për të propozuar në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (anëtarë i të cilit komision jam gjithashtu) që i njëjti Komision të kërkojë nga Zyra Kombëtare e Auditimit që të bëjë auditimin e Radio Televizionin e Kosovës dhe të përgadit raportin për Kuvendin.

Kryetari – rikonfirmoi se në Punëtorinë në Durrës me 24 Shkurt 2017 jemi dakorduar që tre antarët e Komisionit tone (Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka) që njëkohësisht janë edhe antarë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike t'i propozojnë këtij Komisioni që të kërkojë nga Zyra Kombëtare e Auditimit që të bëjë auditimin e Radio Televizionin e Kosovës dhe të përgadit raportin për Kuvendin.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani